



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Nën-komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja nr. 02

Prishtinë, më 23 mars 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Arsim Bajram, Mufera Şinik, Behar Selimi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli dhe Jasmina Živković.

Mungoi: Halit Krasniqi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj - OSBE, Rinor Beka – NDI, Lumnije Murati – ZPRK, Aritan ... - KDI, Artan Canhasi - EULEX, Fixhrije Dragaj dhe Alban Krasniqi – praktikant.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion - Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Visar Krasniqi, Hasan Tahiri dhe Advie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011;
3. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit, Nr. 04-P-005;
4. Të ndryshme.

***Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, që pika e tretë të hiqet nga rendi ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011

Kryetari - I njoftoi të pranishmit se shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, është një ndër ligjet më të rëndësishme në aspektin fiskal dhe ekonomik të Kosovës. Meqë është kërkuar të mbahet kjo mbledhje, edhe pse shqyrtimi i ligjeve bëhet nga Komisioni Funkcional, mirëpo duke pasur e parasysh rëndësinë e tij, është kërkuar që edhe Komisioni për Legjislacion të mbajë mbledhje para leximit të parë, që të japë një kontribut në lidhje me aspektin e dispozitave ligjore të këtij ligji.

Arsim Bajrami - Tha se është mirë që po ndiqet kjo praktikë, që ligjet po shqyrtohen edhe në mënyrë paraprake nga Komisioni për Legjislacion, edhe pse rregullat e procedurës nuk e detyrojnë, sepse kjo bëhet pas leximit të parë, kur ligji u procedohet komisioneve kryesore dhe Komisionit Funkcional. Ajo që po diskutojmë tani ka karakter këshillues për miratimin e këtij ligji, jo nga aspekti përmbajtjesor, sepse është Komisioni Funkcional ai që merret me amendamentimin e këtij ligji, kurse ne e shqyrtojmë vetëm aspektin e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Armend Zemaj - Ne jemi Komision kryesor edhe komision funksional. Duke iu referuar neni 4 ishte i mendimit se është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet e tjera. Në vazhdim tha se kjo nuk mund të tejkalohet në atë mënyrë, sepse një vendim nuk mund ta absorbojë një vendim tjetër, që paraprakisht nuk ka ardhur në Kuvend. Kjo ka të bëjë me privatizimin e PTK-së, që është futur si nen paraprak në nenin 4, të Ligjit për buxhetin.

Albulena Haxhiu - Në emër të G/P paraqiti vërejtjet në Projektligjin për shkak të përmbajtjes së tij. Duke iu referuar neni 4 tha se kjo i hap rrugë shitjes së PTK-së dhe në këtë kontekst jemi kundër këtij neni për shkak se Lëvizja Vetëvendosje është kundër privatizimit të ndërmarrjeve publike, në këtë rast kundër privatizimit të PTK-së. Në nenin 5 të P/L, shihen qartë implikimet e Pakos së Ahtisarit, që për ne janë të papranueshme. Ne e kemi thënë shumë herë se jemi kundër decentralizimit të krijimit të komunave të reja me baza etnike.

Ibrahim Makolli - Në këtë fazë, si komision, është të vlerësojmë nëse P/L është në pajtim me Kushtetutën. Çështjet e tjera të brendshme, janë çështje që deputetët dhe grupet parlamentare, mund t'i thonë në komisionin ku shqyrtohet projektbuxheti dhe në seancë plenare.

Ardian Gjini - Theksoi se nuk mund të themi nuk guxon ose nuk duhet ta shqyrtojmë Projektligjin, sepse jemi Komisioni për Legjislacion, që ka të drejt dhe obligim ta shohë aspektin ligjor të këtij ligji. Duke iu referuar neni 4, tha se ka probleme serioze dhe kushtetuese, ligjore, që në momentin, kur Qeveria e Kosovës provon që me një votë në Kuvend, t'i kalojë dy çështje të ndryshme, që përmes Ligjit për buxhetin provohet të kalohet edhe vendimi i Qeverisë për privatizimin e PTK-së. Në vazhdim ceku se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, nuk është kundër privatizimit të ndërmarrjeve publike, sepse ne mendojmë që ky proces duhet të ndodhë, mirëpo mendojmë se është çështje jetike që procesi i

privatizimit të ndërmarrjeve publike të jetë transparent, të jetë proces që do të krijojë besim te të gjithë qytetarët e Kosovës. Ishte mendimit se Komisioni për Legjislacion duhet t'i rekomandojë Kuvendit të Kosovës të hiqet neni 4.

Behar Selimi – Ishte i mendimit se Komisioni duhet te merret me këtë çështje, pasi që Projektligji të miratohet në parim, i cili pastaj u procedohet komisioneve për ta shqyrtuar. Shprehu mendimin se neni 4 lë të kuptohet se mund të jetë edhe kundërkushtetues, mirëpo deri në mbledhjen e radhës mund ta analizojmë, ta krahasojmë edhe këtë nen, me nenet e Kushtetutës, në mënyrë që në mbledhjen e ardhshme të japim rekomandimin tonë si komision për legjislacion.

Muferra Sinik – Shfaq shqetësimin e saj rreth botimit të disa ligjeve dhe dokumenteve në gjuhën turke, që do të ishin të mirëseardhura, prandaj arsyetimi se nuk ka mjete buxhetore është i pakuptueshëm. Për këtë komisioni për Legjislacion duhet ti propozoi komisionit për Buxhet të sqarohen disa probleme që ekzistojnë në lidhje me këtë çështje.

Arsim Bajrami - Në fjalën e tij të serishme shprehu qëndrimin se duhet të dalim me një rekomandim se ligji ka bazë kushtetuese dhe mund të procedohet për shqyrtimin e parë. Jemi komisioni kryesor dhe duhet të jemi model për komisionet e tjera. Janë dy lexime të ligjeve dhe duhet bërë dallimin se çka kërkohet në leximin e parë dhe çka në leximin e dytë. Duke shtuar se pas leximit të parë do të kemi mundësi të diskutojmë edhe për nenin 4. Edhe institucionet, që janë nën kontrollin parlamentar të këtij Komisioni, mund ta shqyrtojnë buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të agjencive.

Adrian Gjini - Shprehu qëndrimin se duhet të bëhet rekomandim, se ligji ka bazë kushtetuese, nëse nga Projektligji hiqet neni 4. Kjo duhet të bëhet sepse jemi nën tryzni të kohës, ngase tri ditë pas miratimit në parim do ta kemi në shqyrtim të dytë. Mendoj se menjëherë duhet t'i rekomandohet Kuvendit që ky nen të hiqet. Ndoshta nga Komisioni për Legjislacion këtë rekomandim mund ta ketë edhe Qeveria, në mënyrë që vetë Qeveria ta tërheqë nenin 4.

Ibrahim Makolli - Sqaroi se Komisioni do t'i shikojë edhe amendamentet e komisionit funksional, nëse janë në pajtim me Kushtetutën. Ne nuk e dimë, sot, a do të ketë amendament pikërisht në nenin 4 nga komisioni Funksional.

Haki Demolli - Ishte i mendimit se Komisioni duhet ta nxjerrë rekomandimin për kushtetutshmërinë e këtij ligji. Nuk besoj se do të kishte problem edhe nëse i bëhet një vërejtje lidhur me nenin 4. Është mirë ta njoftojmë edhe Kuvendin, por edhe Qeverinë, që të shikohet mundësia e ndryshimit ose e përmirësimit të këtij neni.

Kryetari - Shprehu mendimin se të gjithë jemi dakord se P/L e ka bazën kushtetuese, mirëpo në preambulë, referenca në nenin 21 e ligjit për menaxhimin e financave publike, është e gabuar, pra duhet të jetë referenca në nenin 22. Ndërsa sa i përket nenit 4 të P/L për buxhetin, që ka të bëjë me vendimin për privatizimin e PTK-së, mendoj se është në kundërshtim të plotë me nenin 9 të Ligjit për ndërmarrjet publike, si dhe në kundërshtim me nenin 160.1 të Kushtetutës.

Pas diskutimeve për këtë pikë të rendit të ditës, kryetari e vuri në votim propozimin se a do të paraqesim vërejtje për nenin 4 të Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, gjatë shqyrtimit të tij në parim.

Rezultati i votimit ishte, si vijon: për ----- 10, kundër 1 (Arsim Bajrami).

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me 10 vota “për” dhe 1 votë “kundër”, e nxori këtë:

PËRFUNDIM

Neni 4 i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, është në kundërshtim me nenin 160.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 9 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

3. Të ndryshme.

Lidhur me këtë pikë nuk u ngritën çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi